



ZËRI I POPULLIT

ORGAN I KOMITETIT QENDROR TE PPSH

Viti i 43-të i botimit
Nr. 91 (11.461)

E martë, 16 prill 1985

Çmimi 30 qindarka

Shoku Enver Hoxha është i pavdekshëm, pse e pavdekshme është Vepra e Tij, Partia që Ai themeloi e udhëhoqi, Shqipëria socialiste që Ai ndërtoi.

SHQIPERIA I JEP LAMTUMIREN E FUNDIT BIRIT TE LAVDISHEM, SHOKUT ENVER HOXHA

Miting i përmortshëm në kryeqytet

FJALA E SHOKUT RAMIZ ALIA

Shokë e shoqe, vëllezër e motra,

Po ndahemi nga burri më i madh që ka nxjerrë deri më sot trualli shqiptar, nga themeluesi i Shqipërisë së Re, nga udhëheqësi ynë i shtrenjtë, nga shoku, vëllai e mësuesi ynë i dashur, Enver Hoxha.

Në këtë shesh, ku jemi mbledhur për takimin e fundit me të, 44 vjet më parë Ai udhëhoqi demonstratën e madhe antifashiste dhe i bëri thirrje popullit për kryengritje kundër pushtuesve e tradhtarëve. Dhe që nga ajo ditë e deri sa u shua jeta e Tij, Ai qëndroi në ballë të Partisë e të popullit si prijës legjendar i Luftës Nacional-çlirimtare e udhëheqës heroik i ndërtimit të socializmit.

Jeta dhe veprimtaria e shokut Enver Hoxha është historia e gjallë e popullit shqiptar në këto 50 vjetet e fundit. Ajo është historia e themelimit të Partisë dhe e rritjes së saj, është historia e revolucionit popullor dhe e triumfit të tij, historia e ringjalljes së Shqipërisë dhe e ndërtimit të jetës së re, historia e luftës kundër armiqve të jashtëm e të brendshëm dhe e fitores mbi ta. Emri i Enver Hoxhës është i lidhur me hapjen e rrugëve të gjera në të cilat ka ecur fitimtar populli ynë në vitet e epokës së Partisë. Vepra e Tij është derdhur në të gjitha themelet e shëndosha mbi të cilat është ngritur Shqipëria e sotme, mendja e Tij ka ndriçuar të gjitha lartësitë ku është ngjitur shoqëria jonë, fjala e Tij e urtë, e zjarrtë ka ngrohur zemrat e të gjithë njerëzve tanë.

Enver Hoxha ka qenë jo vetëm pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në kthesat e mëdha të historisë më të re të popullit tonë, por ka ndikuar edhe drejtpërdrejtë në rrjedhën e tyre. Dhe ka qenë një fat i madh për popullin shqiptar, që në ato momente për prijës ka pasur një revolucionar komunist konsekuent, një patriot të flaktë dhe një burrë shteti të shquar si Ai. Në personin e tij Ai mishëronte virtetet më të vyerat të popullit tonë të lashtë, atë karakter luftarak e fisnik, ato tradita të ndritura e heroike, atë shpirt kryengritës e bujar, që janë farkëtuar e kalitur nëpërmjet sa e sa luftërash e vuajtjesh, përpjekjesh shekullore

për liri e pavarësi, për dritë e dije, për fukë e për bukë.

Vetëm një njeri i tillë, kur vendin e shkeli çizma e pushtuesit të huaj dhe e mbuloi errësira fashiste, mund të ndjente tërë peshën e rëndësisë historike të momentit, të kuptonte çfarë kërkonte me të vërtetë populli dhe çfarë duhej bërë për të plotësuar aspiratat e tij. Vetëm një njeri i tillë si Enver Hoxha, që jo vetëm me ndjenjë, por edhe politikisht e ideologjikisht, e kuptonte se cila ishte përgjegjësia e detyra e revolucionarëve dhe e patriotëve shqiptarë, mund të realizonte se cila ishte rruga e shpëtimit të Atdheut.

Akti i madh që kreu Enver Hoxha në atë Nëntor të turbullt e të errët të vitit 1941 duke themeluar Partinë Komuniste, i dha dritën që i mungonte popullit shqiptar, i dha mendjen për të parë të ardhmen, i dha shtabin që do ta udhëhiqte në luftën titanike për jetë a vdekje. Barra që morën komunistët shqiptarë në atë kohë ishte e rëndë dhe shpatullat e tyre ishin shumë të njoma. Por ata e mbajtën atë me nder dhe e çuan deri në fund, pse në krye të tyre kishin një udhëheqës të madh, që dinte mirë çfarë kërkohet e ku duhej shkuar. Ajo që kuptoi Enver Hoxha dhe që e paraqiti me aq kthjelltësi e bindje, që në fjalën e parë të mbledhjes së komunistëve për formimin e Partisë, ishte se popullit shqiptar vuajtjet e fatkeqësitë i vinin, jo vetëm nga të huajt, por edhe nga klasat politike që deri atëherë kishin sunduar Shqipërinë, që gjithnjë kishin bashkëpunuar me ta e që gjithnjë u ishin nënshtruar. Ai e kuptoi se pa luftuar njëkohësisht e me të njëjtën vendosmëri kundër të dy këtyre forcave armiqësore, liria e vërtetë nuk mund të arrihej, pavarësia kombëtare nuk mund të realizohej, aspiratat shoqërore të masave nuk mund të plotësoheshin.

Ai fenomen, ndoshta unikal, që ndodhi në Shqipëri, ku lufta për çlirim kombëtar u shkri me një revolucion të gjerë popullor nuk ishte një rastësi. Pa një bindje të thellë ideologjike dhe pa një qartësi të madhe politike nuk mund të arrihej deri në këtë. Ishte shoku Enver Hoxha ai që këtë ide të madhe krijuese revolucionare e

(Vijon në faqen 2)



RRON POPULLI, RRON ENVERI

Populli është gjeniu. Gjithë jetën shoku Enver punoi dhe luftoi me këtë bindje, e cila i dha forca të pashtershme, e bëri ti-

tan të veprimit revolucionar. Por mendja, syri dhe zëri i këtij gjeniu ishte mendja, syri dhe zëri i Enver Hoxhës.

Populli rron: I gjallë mes të gjallëve është edhe Ai - fjalë-

(Vijon në faqen 3)



Në mitingun e përmortshëm, Shoku Ramiz Alia duke folur.

(Fotot ATSH)

SHQIPERIA I JEP LAMTUMIREN E FUNDIT BIRIT TE LAVDISHEM, SHOKUT ENVER HOXHA

FJALA E SHOKUT RAMIZ ALIA

(Vijon nga faqja 1)

vuri në bazë të vijës së Partisë dhe të platformës së Luftës Nacionalçlirimtare, ishte shoku Enver Hoxha që duke qenë në udhëheqje të Partisë, në krye të Frontit Nacionalçlirimtar dhe në komandë të ushtrisë partizane e bëri të mundur realizimin e saj.

Populli u shkoi pas komunistëve dhe pranoi ta udhëhiqnin jo vetëm për trimërinë, për guximin, për sakrificën e vetmohimin e tyre. Shembulli i tyre, natyrisht kishte rëndësi dhe një rëndësi të madhe, por ai nuk ishte vendimtar. Vendimtar ishte fakti se thirrja që i bënte Partia popullit të luftonte për dëbimin e pushtuesit të huaj dhe për vendosjen e pushtetit popullor shprehte dëshirat e vërteta, ëndrrat shekullore të tij.

Ne kemi thënë e themi se Lufta Nacionalçlirimtare ka qenë më e madhja, me gjithë se luftëra populli ynë ka bërë shumë, gjak ai ka derdhur lumenj, dhe shkatërrimet që ka pësuar e vuajtet që ka hequr nuk llogariten dot. Lufta Nacionalçlirimtare e udhëhequr nga Partia me shokun Enver Hoxha në krye, është e madhe për idetë e saj e mbi të gjitha për rezultatet e saj. Vetëm ajo çoi në sigurimin e lirisë së vërtetë kombëtare e të pavarësisë së plotë të Atdheut dhe, mbi të gjitha, vetëm ajo vendosi pushtetin popullor.

E tërë jeta e ndërgjegjshme e shokut Enver Hoxha ka qenë luftë. Luftë për lirinë e Atdheut, luftë për ndërtimin e socializmit, luftë për emancipimin e popullit, luftë kundër armiqve të jashtëm e të brendshëm që kërkonin të na kthenin mbrapsht në skllavërinë e mëparshme. Ashtu siç qëndroi në ballë të betejave e të përleshjeve të Luftës Nacionalçlirimtare, po ashtu me një guxim të rrallë politik e pjekuri të thellë ideologjike e udhëhoqi Partinë e popullin në ndeshjet me komplotet, presionet e ndërhyrjet e shumta të armiqve gjatë këtyre 40 vjetëve të jetës sonë socialiste. Komunistët dhe populli shqiptar me Enver Hoxhën në krye, i thyen njerzën pas tjetrës intrigat e kërcënimet e imperialistëve, përballuan sulmet antishqiptare të revizionistëve tiftistë, i rezistuan me sukses presioneve të hrushovianëve dhe nuk u mashtruan nga pabesitë e revizionistëve kinezë.

Kur ish-aleatët anglo-amerikanë ngritën furtunat e «luftës së ftohtë» e të «luftës së nxehtë», Enver Hoxha diti ta drejtojë me dorë të saktë anijen e vogël, por të çeliktë shqiptare drejt brigjeve të sigurta. Ai nuk u tronditi pse ata nuk deshën ta njihnin Qeverinë Demokratike që zbriti nga malet shqiptare, as u lëndua nga presionet politike e bllokadat e tyre ekonomike.

Populli shqiptar me Partinë e tij në krye i rezistoi me një krenari të rrallë asaj lufte të gjatë diplomatike dhe dërrmoi me grusht të hekurt përpjekjet e reaksionit e të agjentëve të huaj për të minuar e përmbysur pushtetin e tij popullor. Me gojë të Enver Hoxhës populli ynë u tha atyre që kërcënonin Shqipërinë, se s'kanë lindur akoma ata trima që mund të prekin kufijtë e Shqipërisë, ashtu siç u tha edhe hrushovianëve se ne shqiptarët hamë edhe bar, por përpara presioneve tua nuk përulemi.

Ky guxim e ky qëndrim i paepur qëndrojnë në themelet e kalasë shqiptare, prandaj ajo ka qenë e do të jetë kurdoherë e fortë dhe e pathyeshme nga çdo dallgë e furtunë dhe nga çdo anë që të vijë.

Figura e personaliteti i rrallë i Enver Hoxhës ndritet me një shkëlqim të veçantë edhe atëherë kur tradhtia oportuniste mbuloi lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Partia jonë e Punës me në krye shokun Enver nuk e lejoi revizionizmin modern të kalonte në Shqipëri. Dhe ai nuk kaloi pse Enver Hoxha e kish kalitur Partinë në betejat e ashpra politike për mbro-

tjen e pavarësisë e të socializmit, e kishte edukuar atë t'i qëndronte kurdoherë besnike marksizëm-leninizmit, të ishte deri në fund e papajtueshme me ideologjitë armiçësore të proletariatit.

Lufta ideologjike kundër revizionizmit modern, të cilën shoku Enver Hoxha e ka zhvilluar me aq konsekuencë e aq vendosmëri ka qëndruar e do të qëndrojë kurdoherë në bazë të zhvillimit tonë socialist, ajo ka qenë e do të jetë një detyrë tjetër e përhershme e Partisë dhe e popullit tonë.

Shoku Enver Hoxha është arkitekt i Shqipërisë së Re, organizator dhe udhëheqës i drejtpërdrejtë i gjithë atyre transformimeve revolucionare që janë bërë pas Çlirimit, frymëzues i gjithë atyre veprave monumentale që ia kanë ndryshuar pamjen vendit tonë.

Partia e Punës e Shqipërisë e mobilizoi dhe e udhëhoqi popullin për ta kthyer Shqipërinë nga një vend i varfër në një vend të zhvilluar. Shoku Enver ka hartuar e përcaktuar vijën ekonomike të Partisë. Politika e industrializimit të vendit, e kolektivizimit dhe e modernizimit të bujqësisë mbajnë vulën e mendimit të Tij krijues e original. Ai ka qenë frymëzues i planeve tona pesëvjeçare, të cilat përfaqësojnë shkallët e rritjes e të zhvillimit të ekonomisë sonë, themelet e ndërtimit të bazës ekonomike të socializmit në Shqipëri. S'ka asnjë veprim që është ndërtuar te ne e që të ketë munguar iniciativa e mendimi i Tij. Që nga rindërtimi i urave të para të shkatërruara nga lufta e deri te ngritja e Hidrocentralit të Komarit, që nga rregullimi i parë i shtëpive të djegura nga pushtuesit e deri te Kombinati Metalurgjik, që nga bashkimi i pendëve të para të qeve e deri te fushat e thara të Myzeqesë e taracat e bregdetit, në të gjitha kanë qenë edhe idetë e Tij, nxitja e frymëzimi i Tij.

Vija ekonomike që është ndjekur, rezultatet e shkëlqyera që janë arritur në të gjithë sektorët, e kanë dhënë plotësisht provën e drejtësisë dhe të efikasitetit të tyre. Detyra jonë është të ecim me vendosmëri në këtë rrugë të gjërë që na ka hapur Partia dhe shoku Enver, t'u përmbahemi pa u lënduar orientimeve e mësimëve të Tij, të mobilizojmë edhe më tepër forcat për ta bërë vendin tonë edhe më të lulëzuar, jetën e popullit edhe më të lumtur.

Askush si Enver Hoxha, që kishte dalë nga gjiri i popullit të thjeshtë, që ishte edukuar me ndjenjat e mëdha të rilindasve tanë, që kishte përvetësuar mësimet marksiste për emancipimin e njerëzimit, nuk e ka ndërjetë aq fort etjen e madhe për arsim e kulturë që e ka shqoqëruar popullin tonë në shekuj. Dhe rrallë në donjë vend tjetër mund të jetë bërë një revolucion ideologjik e kulturor aq i thellë për nga përmbajtja dhe aq i shtrirë për nga gjërësia, si në Shqipëri. Rrallë mund të ketë një vend ku brenda një kohe shumë të shkurtër të jetë bërë një kapërcim aq i madh në arsim, në kulturë, në teknikë, në shkencë. Mësimet e mëdha të shokut Enver dhe veprimtaria e Tij e palodhur për të ndërtuar një kulturë të re revolucionare në përmbajtje, me taban të thellë kombëtar dhe me frymë të fuqishme popullore e demokratike, kanë qenë e do të jenë një busull e pagabuar për të na treguar rrugën e drejtë në të cilën duhet të ecim, për të punuar e luftuar pa u lodhur për ta bërë Atdheun tonë një vend gjithnjë e më të emancipuar, gjithnjë e më të kulturuar.

Gjatë gjithë jetës së Tij shoku Enver Hoxha ka luftuar për forcimin e rolit udhëheqës të Partisë, për kalitjen e saj ideologjike e fuqizimin e saj organizativ, për unitetin e radhëve të veta e rritjen e frymës militante të anëtarëve të saj.

Forca e Partisë është forca e shoqërisë sonë socia-

liste dhe siguria e të ardhmes sonë komuniste. Duke i qëndruar besnik Partisë së lavdishme që e themeloi, e rriti dhe e edukoi shoku Enver Hoxha, duke u bashkuar gjithnjë e më ngushtë rreth saj, duke u mobilizuar për të vënë në jetë vijën e direktivat e saj, populli ynë do të arrijë gjithnjë fitore të reja, do ta ruajë të pacënuar lirinë e pavarësinë e Atdheut, fitoret e mëdha të Revolucionit Popullor.

Shoku Enver i porosiste vazhdimisht komunistët të luftonin pa u lodhur për forcimin e vazhdueshëm të lidhjeve të Partisë me masat dhe të unitetit të popullit. Në këto lidhje e në këtë unitet Ai shikonte mburojën e fuqishme ndaj armiqve të brendshëm e të jashtëm, një forcë të madhe lëvizëse e mobilizuese për të çuar gjithnjë përpara shoqërinë tonë, një burim energjie të pashterur për të përballuar çdo situatë.

Partia e populli ynë janë udhëhequr vazhdimisht nga këto mësimet dhe kanë dalë kurdoherë fitimtarë. Kështu do të ndodhë edhe në të ardhmen. Uniteti i popullit rreth Partisë do të qëndrojë kurdoherë i çeliktë. Në muret e tij do të thejxë kokën çdo armik i jashtëm ose i brendshëm që do të orvatet të prejë Partinë e Pushtetin Popullor, fitoret tona socialiste.

Si militant leninist që ishte, shoku Enver ka luftuar gjithnjë për të ruajtur parimet me të cilat fitoi revolucionin ynë popullor dhe u ndërtua jeta e re. Ai e mësoi Partinë t'u qëndrojë kurdoherë besnike mësimëve të Marksit, Engelsit, Leninit, Stalinut dhe gjithë përvojës së luftërave revolucionare të proletariatit botëror, të zhvillojë drejt luftën e klasave dhe të mos harrojë kurrë se ajo është motor që çon përpara shoqërinë njerëzore, të mbrojë pa u lënduar pushtetin popullor, armën e fuqishme të diktaturës së proletariatit, të jetë e papajtueshme me imperializmin e revizionizmin, me ideologjitë borgjeze e oportuniste. Ai e mësoi Partinë e popullin si ta ndërtojë socializmin e si ta mbrojë vendin me forcat e veta, si të jenë krenarë për Atdheun e tyre dhe si të mos përulen kurrë përpara të huajve.

Asnjë nuk mund t'i largojë Partinë e popullin tonë nga këto mësimet, asnjë forcë nuk mund t'i largojë nga politika parimore, nga politika e Enver Hoxhës. Si në të kaluarën, ashtu edhe në të ardhmen Partia jonë, udhëheqja e saj, mbarë populli ynë, klasa punëtore, fshatarësia kooperativiste, rinia, gratë, inteligjencia, veteranët e luftës dhe ushtarët do të ecin kurdoherë përpara në atë rrugë që çeli Revolucionin Popullor dhe që e konfirmoi ndërtimi i socializmit, në rrugën e mbrojtjes së interesave të larta të Atdheut dhe të çështjes së revolucionit.

Enver Hoxha është një figurë e shquar e komunistit ndërkombëtar. Aq sa ishte një patriot i flaktë, Ai ishte edhe një internacionalist i zjarrtë. Lufta dhe vepra e Tij kushtuar përparimit të lëvizjes revolucionare të proletariatit ndërkombëtar, mbrojtjes së marksizëm-leninizmit, përkrahjes së çështjes së çlirimit kombëtar e shoqëror të popujve përfaqëson një shembull të ndritur të përkushtimit të devotshëm ndaj çështjes së komunistit.

Luftëtarët e vërtetë marksistë-leninistë kanë pasur te Enver Hoxha një shok e një mik që i ka përkrahur e inkurajuar kurdoherë vllazërisht. Mendimi i Tij teorik për çështjet e revolucionit, të diktaturës së proletariatit e të ndërtimit të socializmit, analizat për imperializmin e degjenerimin revizionist, janë një kontribut i shquar në thesarin teorik të marksizëm-leninizmit e të praktikës revolucionare botërore.

Shoku Enver Hoxha e ngriti kurdoherë lart zërin e tij të fuqishëm në mbrojtje të të drejtave kombëtare e demokratike që u takojnë vëllezërvë shqiptarë të Kosovës e të viseve të tjera në Jugosllavi. Për këtë qëndrim parimor, të drejtë e korrekt Ai u bë dhe mbeti i

dashur, i respektuar e i nderuar nga të gjithë shqiptarët.

Vepra teorike dhe praktike revolucionare që na la shoku Enver Hoxha është një trashëgimi e madhe. Stili dhe metoda e punës së Tij si udhëheqës Partie e burrë shteti përbëjnë një shembull, të cilit do t'i drejtohen brezat e tanishëm e ata që do të vijin për të mësuar e për t'u orientuar.

Figura e Enver Hoxhës është një figurë e madhe poliedrike. Nuk ka fushë të aktivitetit politik, ideologjik e shoqëror të Partisë e të shtetit që të mos jetë shprehur mendimi i Tij filozofik, forca organizative dhe veprimtaria udhëheqëse.

Rrallë mund të jetë bashkuar te një njeri, mendimtari marksist dhe udhëheqësi i revolucionit, Komandanti Usharak dhe burri i shtetit, diplomati dhe publicisti, intelektual i erudit dhe edukatori i masave, oratori fjalëzjarrtë dhe miku i njerëzve të thjeshtë.

Populli ynë ka qenë e do të jetë kurdoherë krenar për këtë bir të madh që lindi, dhe Partia do të jetë kurdoherë kryelartë për udhëheqësin e saj të shquar që pati. Nderimi më i madh për Veprën e shokut Enver, mirënjohja më e madhe për gjithëcka Ai ka bërë për Partinë e popullin tonë, është të ecim me vendosmëri në rrugën e Tij revolucionare, të përvetësojmë dhe të vemë në jetë mësimet e Tij të pavdekshme, të punojmë e të ndërtojmë si punoi Ai për çështjen e socializmit, për idealet komuniste.

Ne po ndahemi sot me shokun Enver, por Ai rron e do të rrojë përjetë në zemrat e mendjet e popullit shqiptar. Ai është i pavdekshëm, pse e pavdekshme është vepra e Tij, pse e pavdekshme është Partia që Ai e themeloi dhe e udhëhoqi, pse e pavdekshme është Shqipëria socialiste që Ai e ndërtoi.

Veprën e tij të fundit «Kur u hodhën themelet e Shqipërisë së re» shoku Enver e mbylli me besimin se asgjë nuk do ta gjejë Shqipërinë përderi sa popull e Partia janë të lidhura si mishi me kockën. Lart e më lart - na tha Ai - ta ngremë begatinë, sigurinë dhe emrin e Republikës sonë Popullore Socialiste. Në emër të gjakut e të mendit, të djesës e të privacioneve, le t'u transmetojmë brezave që do të vijin mesazhin e madh, të cilin na e mësoi historia: të jemi përherë vijulentë, përherë në punë e në sulm për të mbrojtur dhe për të çuar më tej fitoret e arritura. Të mos lejojmë kërkënd, kushdo qoftë ky, të shkëlqë dhe të mohojë veprën tonë të pavdekshme dhe të shenjtë, Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë. Kështu do të fuqizohet e do të ngrihet edhe më madhështore nga brezi në brez kështjella jonë, Shqipëria socialiste! Zemra jonë të rrahë gjithmonë me zemrën e saj të madhe.

Këtë mesazh Partia jonë nuk do ta harrojë kurrë. Zemra e saj, ashtu siç e desh shoku Enver, do të rrahë kurdoherë si rrahu zemra e Tij e madhe komuniste, si rreh zemra e popullit tonë të lavdishëm.

Shoku Enver na la një Shqipëri të lirë e të pavarur, me një mbrojtje të fortë e të sigurt, me një ekonomi të zhvilluar e të stabilizuar, na la një Shqipëri pa borxhe e pa asnjë detyrim ndokujt. Ai na la një pushtet popullor që ka përkrahjen unanime të mbarë popullit, na la një Partitë të kalitur ideologjikisht e të spastruar nga armiqët, na la një Shqipëri të nderuar e të respektuar në botë.

Partia dhe populli ju betohen, shoku Enver, se të tillë do ta ruajnë e të tillë do ta kenë gjithnjë Shqipërinë, kurdoherë të fortë, kurdoherë të kuqe, ashtu si e donit Ju. Gjithnjë e më përpara do ta çojmë ndërtimin e socializmit, lart e më lart do t'ia ngremë emrin Shqipërisë sonë të dashur.

Lamtumirë udhëheqësi dhe mësuesi ynë i dashur!

Lamtumirë miku dhe vëllai ynë i shtrenjtë!

Lamtumirë shoku Enver!

Të rrojë Partia!



(Fotot ATSH)

SHQIPERIA I JEP LAMTUMIREN E FUNDIT BIRIT TE LAVDISHEM, SHOKUT ENVER HOXHA



(Foto: ATSH)

RRON POPULLI, RRON ENVERI

(Vijon nga faqja 1)

zjarri, oratori ynë i madh që zmarat na i mori me vete. Kohërat dhe brezat që vijnë do të kenë zërin e Enver Hoxhës.

Çna ngjau kështu?! C'dramë e tund dheun e vendit e të kombit?

Në çdo zemër: pikëllim dhe qëndresë

Rrugët e Tiranës nuk vunë gjumë në sy këto net. Sa të vogla qenkan sheshet e tua Tiranë! Nuk i nxënë të gjithë punëtorët, të gjithë fshatarët e pikëlluar. Nuk i nxënë shëtitoretja «Dëshmorët e Kombit» veteranat e perirotur, studentët e rinj që ngashëren. As bulevardi «Stalin» nuk i nxënë tipografët dhe ushtarakët, nënat zemërpërvëlura dhe artistët, gjithë popullin që humbi njeriun e tij më të dashur. Po edhe ti, o sheshi «Avni Rustemi» dhe ti, o sheshi «Qemal Stafa» sa një sofrë dukeni këtë mëngjes! Nga i gjithë alfabeti sot në trotuarët e rrugëve sundojnë «e»-ja dhe «u»-ja, gjuha e dënesës. E kujës. E gjëmës. E vajit. Sot është dita e lamtumirës!

Ora 9.00. Përsëri, plot hidhërim, hyjnë në sallë për të bërë homazhet e fundit shokut Enver udhëheqësit e Partisë e të shtetit.

- Hajdeni shokë, afër - thotë shoku Ramiz Alia - afrohuni ta kemi kështu mes tonë, siç e kemi patur gjithnjë, dhe kështu do ta kemi gjithnjë, kemi mësimet e Tij. Dhe do të ndjekim me besnikëri rrugën e shokut Enver! Lamtumirë, shoku Enver!

Të gjithë i afrohen arkivolit, grusht pranë njëri tjetrit.

Qëndrojnë në heshtje para arkivolit me trupin e Udhëheqësit tonë të shtrenjtë, themeluesit të Shqipërisë së re dhe nderojnë me grushtet lart kujtimin e tij të ndritur.

Çaste të tjera të dhimbjes së thellë kur hyjnë në sallë dhe i bëjnë homazhet e fundit njeriut të tyre më të shtrenjtë, shoqja Nexhmije Hoxha, bashkëshortja dhe bashkëpunëtorja e shokut Enver, fëmijët, motrat dhe të afërmit e familjes. Zemra qan, zemra s'gjen fjalë të shprehë dhimbjen e pafund. Enveri rron, është i gjallë. Ai ka fituar pavdekësinë.

Sot bënë homazhe dhe vendosën kurora gjithashtu shokë nga partitë motra marksiste-leniniste, nga Britania, Majkëll Hamilton; nga Danimarka, Klaus Riis Klausen; nga Franca, Kristian; nga India, nga Irlanda, Liam Dignam; nga Kanadaja, Hardial Beins; nga Portugalia, Eduardo Pires; nga Spanja, Raul Marko; nga Suedia, Nils Anderson; nga Trinidad Tabago, Uinston Zhorzh.

Pas homazheve, këta u pritën për të paraqitur ngushëllimet e tyre nga shokët Ramiz Alia, Adil Çarçani, Lenka Çuko, Manush Myftiu, Foto Çami, si dhe nga shoqja Nexhmije Hoxha.

Shoku Ramiz Alia dhe shoqja Nexhmije Hoxha i falenderuan në emër të Partisë për ndjenjat e tyre të sinqerta e vëllazërore që shprehën me këtë rast.

Gjithashtu bëri homazhe dhe vendosi një kurorë pranë arkivolit të shokut Enver Hoxha si dhe i shprehë ngushëllime shokut Ramiz Alia, dhe shoqes Nexhmije Hoxha, personaliteti i shquar antifashist grek

dhe mik i vendit tonë, Manolis Glezos. Bënë homazhe dhe vendosën kurora edhe miq të Shoqatave të Miqësisë të vendeve të huaja me Shqipërinë.

Studentët duruan gjithë këto ditë zie, por është e pamundur më. Bëjnë homazhe e humbasin në ngashërim.

Nga çdo krahinë e rreth i Shqipërisë kanë ardhur shokët e luftës e të punës të përcillen me shokun Enver. Bën rojë nderi Pandi Kocaqi nga Korça e mezi qëndron nga dhimbja. E, jo veç prej saj. Këmbët e gangrenizuara ia prenë shokët me sharrë në male, në acaret e dimrave të luftës dhe ai nuk derdhi asnjë pikë lot se Partia dhe Komandanti kishin thënë: «Partizanët çdo dhimbje e kthejnë në forcë». Kështu bëri tërë populli.

- Po Enver, një kishim! - thotë Nurihan Bilimani, nëna heroike e Helmësit që priti e përcolli Enver Hoxhën si Bir të vetëm.

Lidhjet e fuqishme të Partisë e të Tijat personale me popullin ishin një domosdo për punën dhe luftën. Gjithçka Partia e kish realizuar e do ta realizonte me popullin. Por... Lamë pa përfunduar bashkë Komandin. Lamë pa përfunduar pallatin e kongreseve, hekurudhën e rinisë Fier-Vlorë!

- Po ç'më bëre, o vëlla! - qan e qan si fëmijë Xhevat Avdalli, - Enver, po kishim lënë të këndonim prapë, o vëlla! Kishim lënë ta merrim gjirokastritë...

Bashkë me Xhevatin kanë ardhur edhe djemat nga Mashkullora, edhe bijt e bija të minoritetit.

Çdo sekondë këtu në këto çaste ka ngjarjen e vet. Fiksojnë shumë prej tyre fotoreporterët, radiokronistët, kineastët, kameramanët e palodhur të Televizionit, fotoreporterët e ATSH-së, magnetofonët e gazetarëve, mendjet dhe zemrat e njerëzve, e megjithatë ajo çka hidhet në letër, në shirit, në celuloide është fare pak nga ai det ndjenjash e lotësh që derdhen njerëzët këtu pranë arkivolit.

- E pabesueshme! - thotë Mahmud Hasani - Burrat e Kalasë së Dodës e ulën kokën në dhë. Edhe Korabi e uli kokën dhe dielli s'bënte dritë më për ne këto ditë.

I rëndë hapi. E rëndë dhirabji. Më i nxehë loti këtë mëngjes! Njerëzit, populli ndahet me Udhëheqësin e vet.

Ngushëllimi më i madh i popullit

Sa herë që dilje Ti, Enver, edhe koha hapej. Por sot ajo nuk u hap! Vjen ora 10.00. Është momenti kur dënesat e njerëzve nuk përmbahen më. Udhëheqësit e Partisë e të Shtetit dalin nga selia e Presidiumit të Kuvendit Popullor, duke mbajtur mbi supë arkivolin me trupin e të shtrenjtë Enver, të mbështjellë me flamurin kombëtar. Mbajnë mbi supë mësuesin e shokun e tyre të dashur e të paharruar.

Arkivoli vendoset në shtratin e një topi.

Truprojës së nderit i jepet komanda «Sup armë! Para marsh! dhe nën tingujt e muzikës funebre kortezhi i përmortshëm lëviz ngadalë në shtetitoren «Dëshmorët e Kombit» drejt Sheshit «Skënderbe».

Pas truprojës së nderit ecin një grup ushtarakësh që mbajnë në jastëkë të kuq dekorat e larta «Hero i Popullit», «Hero i Punës Socialiste» dhe urdhrat e shumta që Presidiumi i Kuvendit Popullor i ka akorduar shokut Enver. Të panumërta janë kurorat me lule të freskëta, kurora



(Foto: ATSH)

që i ka sjellë sot këtu e gjithë Shqipëria. Ato i mbajnë në duar studentët të Universitetit të Tiranës «Enver Hoxha». Ngashërma e dhjetëramijë njerëzve shket nga gjoksi në gjoks me një frymëmarrje si një rrymë elektrike. Truproja e nderit para Teje, Komandantit lavdishëm, nuk luan as qerpikun, por lotëve ç'tu bëjnë djemat e popullit që u shkojnë rreke e u bijen mbi puskë!

«Para marsh!» - u jep komandën shoku i tyre dhe ata lëvizin ngadalë drejt sheshit «Skënderbe». Ecin Ti sot, ecën mbi shtratin e topit. Para teje janë bijtë e popullit që mbajnë dekorat e Tua, janë studentët që mbajnë lulet që të ka sjellë Shqipëria Ty. Pas Teje janë shokët, bashkëluftëtarët më të afërt. Pas vjen historia. Hapi ndalet përpara selisë të Komitetit Qendror. Kortezhi i përmortshëm hedh sytë të dritarja e zyrës Suaj. Aty është projektuar kjo Shqipëri që kemi sot në sy dhe e ardhmja. Elegji e ballada kanë shkruar poetët:

O prill sterrë, o prill i zi!
Ty lulet nuk t'i duam!
Te Komandanti shtrirë atje
kurorë lotësh çuam.

Heshtje varri në sheshin «Skënderbe». Populli është mbledhur në

mitingun e përmortshëm të lamtumirës. Më shumë ky është kuvend i betimit të popullit përpara Prijisit të vet të lavdishëm.

Ora 11.00. Sheshi «Skënderbe» është i mbushur si rrallë herë.

Në këtë miting të madh të përmortshëm kanë ardhur edhe përfaqësues nga të gjitha rrethet e vendit. Në shesh lartohen katër portrete të mëdha të shokut Enver dhe parullat

të qeverisë, kuadro drejtuese të dikastereve, të institucioneve të ndryshme qendrore, të organizatave të masave, të organeve të Partisë, të pushtetit e të ekonomisë të të gjitha rrethëve të vendit, Heronjtë Popullit e të Punës Socialiste, ushtarakë, pjesëtarë e të afërm të familjeve të dëshmorëve etj.

Në këto çaste solemne e të dhimbjes së thellë, e merr fjalën shoku Ramiz Alia.

Dhimbja është e rëndë, e jashtëzakonshme, por ja sapo kortezhi i përmortshëm nis drejt Varrezave të Dëshmorëve të Kombit mijëra pionierë e mposhtin dhimbjen dhe shpërthejnë thirrjen madhore të kohës së Partisë «Parti-Enver - jemi gati kurdoherë!». E vazhdojnë punëtorët, veteranët... Jeta, puna dhe lufta që kemi përpara janë betimi më i madh. Ecin dhe qajnë me dënesë njerëzit. I japin lamtumirën e fundit Enver Hoxhës! E përcjellin me sy arkivolin mbi shtratin e topit. Fle i pagjumi ynë i madh!!

Mbaje në gj Enver Hoxhën, o Nënë Shqipëri!

Varrezat e Dëshmorëve të Kombit. «Nëna Shqipëri» pret birin e saj më të dashur. Këtu dhimbja arrin kulmin. Vjen të prehet këtu bashkë me shokët e tij, bashkë me bijtë e zgjedhur me dorë të popullit, me djemtë e nënave Ai, Enver, Udhëheqësi, Mësuesi, Shoku, Vëllai, Miku i njerëzve të thjeshtë.

Ora 12.30 Truproja merr komandën «Për nder armë!». Udhëheqësit e Partisë e të shtetit përsëri mbajnë mbi supë arkivolin me trupin e shokut e mësuesit të tyre të dashur, të Udhëheqësit të lavdishëm të Partisë e të popullit, shokut Enver Hoxha. Mezi hidhen hapat drejt varrit. Hapa të vegjël, të ngadalë. Sa i rëndë ky arkivol! A mund të mbahet pesha e kësaj dhimbjeje kaq të thellë, e kësaj humbjeje tepër të rëndë e të pazëvendësueshme?

Arkivoli me trupin e Udhëheqësit zbrit në varr. Dënesat e ngashërimit shpërthejnë më fort.

Dhimbja të shpon thellë në kraharor.

- Vdekje s'do të ketë për Enver Hoxhën, por vetëm ditëlindje do të ketë - i thotë me lotë në sy shoku Ramiz Alia shoqes Nexhmije Hoxha. - Njerëz si Ky nuk vdesin. Vetëm një datë ka: 1908, të tjerat nuk ekzistojnë më.

- Kemi udhëheqje të mirë, kemi Partinë të mirë - thotë shoqja Nexhmije Hoxha. - Ti vetë e kalite, ti vetë e përgatite. Erdhe të shokët e luftës. Por edhe ata nuk gëzojnë që erdhe këtu sot. Do të kenë pranë Komandantin e Përgjithshëm. Luftove 40 e ca vjet dhe erdhe te shokët. Të rrojtë Partia! Ta kemi të fortë Partinë!

- Do të rrojtë me Partinë, me popullin gjithë jetën - thotë shoku Ramiz Alia.

Në varr hidhet dhe nga toka mëmë që e desh ai shumë, hidhet dhe nga vendllindja, nga Gjirokastra e shtrenjtë si gjithë Shqipëria, nga oborri i shtëpisë së dashur... Një grusht dhe hedhin të gjithë, puthin dheun dhe me dorë të dridhur e hedhin në varr...

Në këtë kohë është ndërprerë puna për 5 minuta në të gjithë qendrat e punës e të prodhimit të Atde-

ut tonë socialist. Ranë me dhimbje sirenat e fabrikave, trenave e anijeve. Ushtojnë njëzet e një breshëri topi në kryeqytet dhe nga pesë breshëri në qytetet Gjirokastër, Vlorë, Krujë, Korçë, Peshkopi, Shkodër, Kukës, Berat, Durrës e Elbasan.

Ja, mbi varr vendosen tani pllakat prej mermeri të kuq. Mbi mermer është shkruar me germa të arta: «ENVER HOXHA 1908 - 1985». Udhëheqësit e Partisë e të shtetit, shoqja Nexhmije Hoxha e pjesëtarët e familjes së shokut Enver, të gjithë prekin me dorë të dridhur këto germa të arta, përjetë të ndezura, përjetë të dashura.

Ekzekutohet Himni Kombëtar Ngrihen grushtet lart!

Në këto çaste, kur dhimbja më e madhe i ka pushtuar të gjithë, shoku Ramiz Alia thotë:

- Fli i qetë, o shoku Enver, se populli e Partia me Ty gjithnjë në mendje e në zemër do të ecin në atë rrugë që ke caktuar Ti. Dhe Shqipëria do të lulëzojë, Shqipëria do të gëzojë siç e dëshironit Ju! Lamtumirë, shoku Enver!

Mbi varr vendosen pastaj kurora të panumërta. Kurorën në emër të Komitetit Qendror të Partisë me mbishkrimin «Themeluesit të Partisë dhe udhëheqësit të popullit, shokut tonë të dashur Enver Hoxha» e vendosën shoku Ramiz Alia dhe shoqja Lenka Çuko. Shoqja Nexhmije Hoxha, bashkëshortja dhe bashkëpunëtorja e shokut Enver, vendosi kurorën me mbishkrimin «Shokut tim të jetës e të luftës - Nexhmija». Në emër të Presidiumit të Kuvendit Popullor kurorën e vendosën shokët Rita Marko e Pali Miska, të Këshillit të Ministrave, shokët Adil Çarçani, Manush Myftiu, të Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë shokët Simon Stefani e Muho Asllani, të Komitetit Kombëtar të Veteranëve të Luftës së Popullit Shqiptar shokët Shefqet Peçi e Hajredin Çeliku, të Ministrisë së Mbrojtjes Popullore shokët Hekuran Isaj e Prokop Murra. Kurora vendosën gjithashtu fëmijët, motrat dhe të afërmit e familjes së shokut Enver Hoxha.

Te varri i shokut Enver u vendosën kurora edhe në emër të organizatave të masave të të gjitha dikastereve e institucioneve të ndryshme qendrore, të Komitetit të Partisë e të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit të Tiranës, të banorëve të lagjes Palorto në Gjirokastër, në emër të ndërmarrjeve ekonomike, kooperativeve bujqësore e institucioneve që mbajnë emrin e shokut Enver Hoxha, të aparatit të Komitetit Qendror të Partisë, të organizatës - bazë të Partisë ku militoi shoku Enver etj etj.

Pas kësaj ceremonie, truproja e nderit bëri parakalimin nën tingujt e marshit luftarak. Televizioni e transmeton drejtpërdrejt këtë ceremoni të përmortshme, e kjo do të thotë që gjithë shqiptarët me sy e me zemër janë këtu, janë duke u betuar përpara Veprës dhe jetës së Enver Hoxhës.

Lamtumirë shoku Enver Lamtumirë!

Të rrojtë Partia!
Këto fjalë i tha çdo zemër sot. I tha populli. I thanë komunistët. Do t'i thonë brezat që do të vijnë në këtë tokë të lashtë.

PËRPARIM XHIXHA
SHABAN SINANI

Tiranë, 15 prill 1985

